



2 SHKURT—DITA BOTËRORE E LIGATINAVE



Në 2 shkurt, Ditën Botërore të Ligatinave, Ministri i Mjedisit, Z. Lefter Koka, dha këtë mesazh për të gjithë shqiptarët, por në veçanti për ata banorë që jetojnë pranë këtyre zonave ligatinave.

“Sot është Dita Botërore e Ligatinave, një prej pasurive të vryra që natyra i ka falur edhe vendit tonë. Ato janë burim i vlerave të mëdha ekonomike, kulturore, shkencore dhe rekreative, dhe si të tilla janë dhe do të jenë në fokus të politikës sonë mjedisore për një zhvillim të qëndrueshëm.

Shqipëria, si palë e Konventës Ramsar, kujton këtë ditë bashkë me vendet e tjera edhe për rëndësinë që ato kanë. Ndër të tjera, rëndësia ndërkombëtare e ligatinave qëndron në strehimin e shpendëve të veçantë ujorë migratorë, që gjithmonë e më shumë zgjedhin ligatinat tona për të dimëruar, falë qetësisë së siguruar nga Moratoriumi i Gjuesit!

Le t'i mbrojmë dhe t'i zhvillojmë së bashku këto zona me potenciale të larta natyrore dhe me rëndësi të veçantë jo vetëm kombëtare, por edhe ndërkombëtare.”

PAK HISTORI PËR 2 SHKURTIN

Kjo ditë shënon datën e nënshkrimit të Konventës “Për Ligatinat”, më 2 Shkurt 1971, në qytetin iranian të Ramsarit, në brigjet e Detit Kaspik. Dita Botërore e Ligatinave u festua për herë të parë në vitin 1997. Çdo vit, agjencitë qeveritare, OJF-të

dhe grupet e qytetarëve në të gjitha nivelet e komunitetit shfrytëzojnë mundësinë e ndërmarrjes së veprimeve me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për vlerat e ligatinave dhe përfitimet në përgjithësi, si dhe të Konventës së Ramsar-it në veçanti.

Sot Konventa numëron 159 shtete palë dhe ka në listën e saj 1883 ligatina me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht për mbrojtjen e shpendëve të ujit migratore. Ligatinat zënë 6% të sipërfaqes së Tokës. Gjatë historisë së saj, puna e Konventës Ramsar për Ligatinat (tokat e lagëta), në të cilën vendi ynë është palë, është përqëndruar në përpjekjet për të ruajtur pasuritë që këto zona ofrojnë, kjo jo vetëm për mirëqenien ekonomike dhe sociale të zonës, por dhe për të ruajtur atë që konsiderohet si “trashëgimi kulturor”.

Qeveritë e shumë vendeve anëtare në Konventën Ramsar ndërmarrin aktivitete të ndryshme në këtë ditë për të ndërgjegjësuar qytetarët e tyre për atë që ata e konsiderojnë si “përdorim i matur”, sinonim me përdorimin e termit ‘qendrushëm’. Në të njëjtën kohë, klasat e shkollave të niveleve të ndryshme arsimore, klubet me fokus natyrën, shoqatat e mbrojtjes së Mjedisit në përgjithësi e shpendëve në

veçanti, menaxherët e parqeve në nivel lokal, gjejnë rrugë për të ndërgjegjësuar komunitetet e tyre dhe për të çuar pranë banorëve vlerat e ligatinave.


LIGATINAT NE SHQIPËRI

Shqipëria ka aderuar në Konventën e Ramsar-it në vitin 1997. Në zbatim të detyrimeve të kësaj konvente mjedisore janë shpallur dhe miratuar si zona Ramsar 4 ligatina të Shqipërisë: Karavastaja, Butrinti, Kompleksi Ligatinor i Liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna, si dhe së fundmi në 2013 u bë pjesë dhe Liqeni i Prespës. Të katërta ligatinat së bashku arrijnë një sipërfaqe prej 98.181 ha.

Sipas studimeve të kryera në Shqipëri, citohen se ekzistojnë 5 lloje ligatinash, të ndara sipas origjinës së formimit dhe funksionit. Sipërfaqja më e madhe mbulohet nga liqenet hidroenergjike, të ndjekura nga liqenet natyrore (tektonik, glacial, karstik) dhe sistemet e ligatinave bregdetare. Në një hapësirë që përbën më pak se 3.2% të gjithë territorit të vendit gjenden më shumë se 70% e vertebrorëve, veçanërisht shpendë, reptilë dhe gjitarë. Rreth 65 nga vertebrorët e ligatinave janë identifikuar si lloje globalisht të rrezikuara.



MINISTRI I MJEDISIT TAKIM ME AMBASADORIN E MBRETËSISË SË NORVEGJISË NË SHQIPËRI



24 Shkurt 2017 - Ministri i Mjedisit, Z. Lefter Koka, priti sot, në një takim, Ambasadorin e Mbretërisë së Norvegjisë për Shqipërinë, Z. Per Strand Sjaastad.

Ministri Koka e njohu ambasadorin Sjaastad: me reformat, nismat dhe arritjet në fushën e mjedisit, duke vënë theksin në prioritetet, objektivat dhe projektet konkrete të Qeverisë Shqiptare dhe Ministrisë së Mjedisit. Ai, gjithashtu në fjalën e tij, u ndal në veçanti në dy reformat ligjore dhe administrative, siç janë moratoriumi i pyjeve dhe i gjuesit; dy reforma, që tashmë po ndikojnë me rezultate pozitive, në rritjen e florës dhe faunës në vend. Më pas, ministri Koka vuri theksin në objektivin kryesor për vitin 2017, që ka të bëjë me menaxhimin e integruar të mbetjeve në vend.

Ministri Koka theksoi se menaxhimi i mbetjeve ngelet një nga prioritetet kryesore për Qeverinë Shqiptare, pasi në këtë drejtim ka pasur një kontribut të madh financiar, si nga ana e

buxhetit të shtetit, ashtu dhe nga ana e donatorëve të huaj.

Gjatë takimit, palët diskutuan rreth çështjeve mjedisore më të prekshme në Shqipëri, siç janë forcimi dhe zbatueshmëria e kuadrin ligjor, ku ministri Koka theksoi se institucioni, që ai drejton, ka në fokus të punës së tij veçanërisht: rritjen e ndërgjegjësimit të opinionit publik dhe angazhimin konkret të qytetarëve shqiptarë për mbrojtjen e mjedisit.

Gjithashtu, Z. Koka theksoi se puna e Ministrisë së Mjedisit është fokusuar dhe në plotësimin e angazhimeve të direktivave të Bashkimit Evropian në mjedis, në kuadër të hapjes së negociatave për anëtarësim në BE, ku mjedisi është një kapitull i rëndësishëm për përmbushjen e detyrimeve.

Ambasadori Sjaastad, nga ana e tij, u shpreh se mbështetja e Norvegjisë, në fushën e mjedisit, synon të thellohet në vitet në vazhdim, duke theksuar mbështetjen që Mbretëria e Norvegjisë mund t'i japë Shqipërisë në fushën

e mjedisit, sidomos në drejtimin e forcimit të kapaciteteve të Ministrisë së Mjedisit dhe institucioneve të saj të varësisë.

Ambasadori Sjaastad shprehu interes konkret për çështjen e diskutuar mes palëve, për ofrimin e asistencës dhe trajnimin nga institucionet homologe norvegjeze, për forcimin e kapaciteteve njerëzore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve.

Ambasadori Sjaastad siguroi se mbështetja, asistenca dhe ekspertiza e vendit të tij për Shqipërinë do të intensifikohet edhe më tej në një periudhë afatshkurtër, duke e konsideruar mjedisin si një fushë prioritare që Norvegjia mbështet për zhvillimin e qëndrueshëm të vendeve në zhvillim.



NE KËTË NUMËR:

2 SHKURT—DITA BOTËRORE E LIGATINAVE FQ 1.

MASA NDËRSHRITËSE PËR SUBJEKTET QË NUK ZBATOHIN LEGJSLACIONIN MJEDISOR FQ 2

RAPORTI I TRETË I PERFORMANCËS MJEDISORE FQ 3

AKTIVITETET BIOBLIZ GJATË MUAJIT JANAR FQ 4

“Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Përmbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, xjitur dhe bashkërenduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilituar opinionin publik”.

MASA NDËRSHKUESE PËR SUBJEKTET QË NUK ZBATOJNË LEGJISLACIONIN MJEDISOR

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe i Pyjeve (ISHMP), në vijim të objektivave dhe në zbatim të legjislacionit, ka përmbyllur suksesshëm edhe një vit tjetër pune, në ushtrimin e kontrollit për veprimtaritë që kanë ndikim në mjedis.

Gjatë prezantimit të analizës së punës për vitin 2016, Z. Ergys Agasi, Kryeinspektori i ISHMP-së, theksoi faktin se të dhënat shënonin rezultate pozitive. Gjatë vitit 2016 vihet re një rritje cilësore e kontrollit të ushtruar nga ky institucion, gjë që duket dhe në statistikat e kontrolleve për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015. Kështu për vitin 2016, ISHMP-ja ka realizuar 7353 inspektime ose 58% më shumë inspektime krahasuar me vitin 2015.

Rritja e numrit të inspektimeve ka sjellë rritjen e numrit të masave administrative, kështu për 2016-ën janë vendosur 15.3% më shumë gjopa në një vlerë monetare 7.9% më shumë se në vitin 2015. Për herë të parë, vitin e kaluar, janë vendosur 11 dënime me paralajmërim, si dhe janë marrë masat për pezullime dhe mbyllje aktivitetesh me 48% më shumë krahasuar me vitin 2015.

Gjithashtu, ka një rritje të kontrolleve dhe në subjektet industriale dhe aktivitetet prodhuese, ku numri i inspektimeve është rritur 15.5% më shumë se në vitin 2015.

Kjo ka sjellë një dyfishim të sanksioneve administrative krahasuar me vitin 2015. Vlera totale e gjobave është në masën 64 % më shumë se në vitin 2015.

Puna e sektorit për inspektimin e burimeve natyrore është përqëndruar në inspektimet e kryera nga ISHMP-ja në aktivitetet minerale, gurore, subjekteve në zonat naftë e gazmbajtëse, si dhe në inspektimin e aktiviteve që përdorin burimet ujore. Në këtë fushë, gjatë vitit të kaluar, janë kryer 93 inspektime dhe janë vendosur 45 masa administrative.

Nga inspektimet e kryera në rang vendi, për menaxhimin e mbetjeve urbane, janë marrë 23 masa administrative. Nga këto, 5 masa me gjobë janë vendosur për kryebashkiakët e bashkiave Pustec, Pogradec, Sarandë, Devoll dhe Librazhd; të cilët janë gjobitur me një vlerë prej 500.000 lekë secili. Masa administrative me gjobë janë marrë edhe për disa ndërmarje publike.

Gjatë vitit 2016, objekt inspektimi u bënë dhe subjektet e licensuara nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për të parë realizimin e kushteve të kontratave që lidhin me operatorët që gjenerojnë mbetje spitalore për çdo qark. Masa administrative me gjobë janë marrë edhe ndaj institucioneve publike shëndetësore, si për: Spitalin Rajonal Korçë; Qendrën Shëndetësore Hekal, Mallakastër; spitalin

“Ihsan Çabej”, Lushnjë; Drejtorinë e Shëndetit Parësor Dibër dhe Drejtorinë e Shëndetit Parësor Shkodër.

Gjithashtu, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, gjatë vitit 2016, ka punuar edhe për kontrollin e automjeteve në fund të jetës, bazuar në legjislacionin vendas, duke shënuar 16% më shumë inspektime krahasuar me vitin 2015. Në këto kontrole është vënë re me kënaqësi se ka pasur një rënie me 27% të vlerës së gjobave, duke treguar në këtë mënyrë se kemi një rritje të ndërgjegjësimit të operatorëve për zbatimin e ligjit.

Një objektiv i rëndësishëm në fushën e inspektimeve është dhe kontrolli i subjekteve private që veprojnë në fushën e turizmit. Gjatë 2016-ës, ka pasur një rritje në 8% më shumë inspektime në fushën e turizmit, që ka rezultuar me 22% më shumë pezullime aktivitetesh të këtyre subjekteve private krahasuar me 2015-ën.

Në fund të kësaj analize, Kryeinspektori, Z. Agasi, theksoi se vendosja e masave administrative nuk është prioritet i këtij Inspektorati, por zbatim rigoroz ndaj subjekteve që duan të rrisin fitimet e tyre, duke anashkaluar mjedisin. Ndaj në këtë dalje për shtyp, Z. Agasi kërkoi nga të gjitha subjektet që kanë ndikim në mjedis, zbatimin e ligjit në funksion të ruajtjes së natyrës në të gjithë territorin e vendit, për një shëndet më të mirë për qytetarët.

PROJEKTI EIMMS- INFORMACIONI MJEDISOR SA MË KONKRET PËR KOMUNITETET VENDORE



3 Shkurt - Në Ministrinë e Mjedisit, u mbledh komiteti drejtues i projektit “Krijimi i Sistemit të Menaxhimit dhe të Monitorimit të Informacionit Mjedisor në Shqipëri në Përputhje me Raportimin Global (EIMMS)”, i financuar nga UNDP-ja. Komiteti drejtues i këtij projekti është krijuar me përfaqësues nga të gjitha institucionet në nivel qendror, që kanë lidhje me fushën e Mjedisit, si përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, përfaqësues të Ministrisë së Energjisë, të Ministrisë së Ekonomisë, përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, si dhe përfaqësues të

Universitetit të Shkencave të Natyrës dhe anëtarë të shoqërisë civile. Në pjesën e parë të takimit, drejtuesja e projektit, znj. Odeta Çato, prezantoi ecurinë e aktiviteve të ndërmarra deri tani në kuadër të këtij projekti.

Projekti është hartuar dhe ka si qëllim të tij: forcimin e kapaciteteve për monitorimin e mjedisit dhe menaxhimin e informacionit në Shqipëri, përmes krijimit të një sistemi operativ për menaxhimin dhe monitorimin e informacionit mjedisor me fokus biodiversitetin, ndryshimet klimatike dhe degradimin e tokës.

Projekti ka si objektiv të tij: dhënien e një informacioni mjedisor sa më konkret për komunitetet vendore, përfshirë dhe çështjet gjinore. Gjithashtu, ka si objekt vlerësimin e të dhënave, të lidhura me Konventën e Rio-s, në mënyrë që të jenë të vlerësuar dhe të prekshme nga të gjithë. Si objektiv më vetë, ky projekt ka dhe gjithëpërfshirjen e komuniteteve vendore, institucioneve arsimore dhe organizatave të shoqërisë civile, në ciklin e të dhënave dhe në aktivitetet konkrete mjedisore. Në përfundim, të pranishmit diskutuan dhe ranë dakord me planin vijtor të punës, që do ndiqet në vijim nga projekti.

VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS JANAR 2017

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi	Hartoi Dosjen
1	OSHEE Velipojë	VP Nënstacioni i Velipojës për 110/20 Kv”	Velipojë, Shkodër	Plotësim Informacioni	Kristela Papa
2	OSHEE Fier	VP Nënstacioni i Fierit për 110/20 Kv”	Fier	Vendim për VNM Paraprake	Kristela Papa
3	Bashkia Vlorë 5	VP Rehabilitimi i rrugës Transballkanike (Faza 1 dhe 2 lidhja e rrugës Transballkanike me autostradën Fier – Vlorë	Vlorë	Vendim për VNM Paraprake	Razie Naipi
4	Bashkia Vlorë 6	VP Rikonstruksioni i rrugës Dhimitër Konomi	Vlorë	Vendim për VNM Paraprake	Razie Naipi
5	Bashkia Vlorë 7	VP Rikonstruksioni i rrugës unazë Vlorë (Poliklinika – 7 Pallatet)	Vlorë	Vendim për VNM Paraprake	Razie Naipi
6	Bashkia Vlorë 8	VP Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë e plazhit të Vlorës	Vlorë	Plotesim Informacioni	Razie Naipi
7	MBZHRAU	VP Kapanon për karantinë	Fushë-Krujë, DR	Vendim për VNM Paraprake	Laert Shehu
8	Knauf	VTH Shfrytëzim i mineralit të gipsit, objekti Grevë	Dibër	Deklarate Mjedisore	Remzi Pupli
9	Yldon	VTH Zgjerim i sipërfaqes së shfrytëzimit të mineralit të kromit me punime sipërfaqesore dhe nëntokësore, zona minerare 147/5, objekti Fushë-Lopë	Dibër	Deklarate Mjedisore	Studio Projekt
10	Derveni dhe Geared	VP Ndërtim strukture 6 kate banimi dhe shërbimesh, 1 kat nëntoke parkim	Tiranë	Vendim për VNM Paraprake	Gezim Haxhiu
11	Materia Cons.AL	VP Godinë banimi 6-8 katëshe	Rr. Dali Ndreu", Tiranë	Vendim për VNM Paraprake	Shpresa Gjura
12	E - 88	VP Godinë banimi 6-8 katëshe	Tiranë	Vendim për VNM Paraprake	EMC Studio

RAPORTI I TRETË I PERFORMANCËS MJEDISORE



Me kërkesë të Ministrisë së Mjedisit të Shqipërisë, drejtuar Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Europën (UNECE), Shqipëria iu nënshtrua për herë të tretë Procesit të Rishikimit të Performancës Mjedisore (EPR). Raporti i fundit për Shqipërinë daton në mars të 2012, ndaj gjatë muajit shkurt, Misioni i Kombeve të Bashkuara mbledhi informacione të detajuara dhe fakte mbi ecurinë e reformave në fushën e mjedisit që nga viti 2012. Gjatë 10 ditëve të qëndrimit të tij në Shqipëri, ky Mision u takua me përfaqësues kombëtar lokal dhe të qeverisë, OJQ-ve dhe sektorin privat, për të kuptuar drejt çështje të veçanta që do të mbulohej nga EPR-ja, si dhe për të përgatitur kapitujt e tyre përkatës, të cilët do të përfshijnë një analizë dhe një seri konkluzionesh dhe rekomandimesh për Shqipërinë. Për çdo kapitull që do të trajtohet në këtë raport, Ministria e Mjedisit kishte vendosur një përfaqësues, si pikë kontakti, për të bërë një panoramë të plotë të ndryshimeve, si: në bazë ligjore,

ngritje kapacitetesh apo strukture të re, që kishin ndodhur për periudhën kohore nga viti 2012 e deri më sot. Gjithashtu, Misioni u takua dhe me përfaqësuesit e ministrive të linjës dhe organizatat joqytetërore në fushën e mjedisit, për të mbledhur fakte dhe informacione edhe nga grupet e tjera të interesit.

ÇFARË ËSHTË “RISHIKIMI I PERFORMANCËS MJEDISORE” (EPR) ?

EPR-ja është një vlerësim i pavarur dhe i jashtëm, që kryhet nën kujdesin e Komitetit të UNECE-së për politikën mjedisore dhe vlerëson përpjekjet e një vendi, për të reduktuar ndotjen e përgjithshme dhe për të menaxhuar burimet natyrore. EPR-ja shqyrton se si mjedisi përfshihet në politikën socio-ekonomike dhe monitoron bashkëpunimin me bashkësinë ndërkombëtare dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor, politikave dhe strategjive. Qëllimi i EPR-së është të ndihmojë vendet me ekonomi në tranzicion, që të përmirësojnë menaxhimin e tyre mjedisor, duke

rekomanduar zbatim më të mirë të politikave. Duke qenë se mjedisi përbën shtetësim për publikun e gjerë, EPR-ja ka për qëllim një përfshirje më të madhe të publikut në debate dhe në vendimmarrje për çështjet mjedisore.

Programi i UNECE-së -EPR, rrjedh nga Programi i Mjedisit për Rishikimin e Performancës Mjedisore të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), që u krijua në vitin 1991, për të ndihmuar vendet anëtare të OECD-së, si dhe për të përmirësuar menaxhimin e mjedisit në vendet e tyre. Në vitin 1996, programi u shtri në rajonet që mbulon UNECE-ja, ndërsa Komiteti për Politikën Mjedisore u përfshi në programin e punës të UNECE-së. Grupi i synuar i EPR-së përbëhet nga vende të Evropës Lindore, Juglindore, Kaukazit dhe Azisë Qendrore. Programi është vullnetar dhe një vlerësim EPR-je ndërmerr vetëm me kërkesën e një shteti anëtar të UNECE-së.

TRAJNIM AGJENSIVE RAJONALE TË MJEDISIT PËR TËRHEQJEN E PUBLIKUT NË VENDIMMARRJE

Zhvillohet trajnimi mbi përmirësimin e organizimit të dëgjësive të publikut në procesin e VNM-së dhe lejeve mjedisore.

Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit organizuan ditën e mërkurë, datë 22 shkurt 2017, në Ministrinë e Mjedisit, trajnimin me temë “Tërheqja e Publikut në Vendimmarrjen Mjedisore”. Trajnimi ishte ideuar për punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, të cilët merren me procesin e konsultimit publik, gjithashtu dhe për drejtuesit e Agjencive Rajonale Mjedisore.

Trajnimin e hapi znj. Laura Targaj, e cila theksoi rëndësinë që ka pjesëmarrja e publikut në procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe në procesin e lejeve mjedisore. Më pas përgjegjësjë e Sektorit të Transparencës dhe Komunikimit, znj. Enkelejda Malaj, theksoi arsyet krye-

sore që e kishin shtyrë Ministrinë e Mjedisit për organizimin e këtij trajnimi. Ajo e vuri theksin në monitorimin që po i bëhet këtij procesi tashmë jo vetëm nga Sekretaria i Konventës së Aarhusit, konventë ku Shqipëria është bërë palë që në vitin 2000, por dhe faktit që ky proces është bërë shumë i monitoruar dhe i kontestuar nga shoqëria civile e veçanërisht shoqatat mjedisore.

Gjatë prezantimit, të pranishmëve iu shpjegua se çili është niveli i përfshirjes së publikut në proceset e ndryshme vendimmarrëse dhe kujdesi që duhet të tregohet nga zhvilluesi i aktivitetit, nën vëzhgimin e ARM-së, për ndjekjen e hapave në procesin e informimit të publikut, që në fazën e hershme të ndërtimit të një sipërmarrjeje që ka ndikim në mjedis. Informimi për ngritjen e një aktiviteti që ka ndikim në mjedis, duhet të jetë për të gjithë publikun në përgjithësi, por dhe për publikun e ndikuar në veçanti.

Gjithashtu, gjatë trajnimit iu shpjegua të pranishmëve se çfarë nënkuptohet në Konventën e Aarhusit, por dhe në legjislacionin vendas me “organizimin e dëgjësës së publikut pranë zonës ku ndërtohet aktiviteti”, pasi në praktikën e deritanishme vihet re, në disa raste, se dëgjësja e publikut organizohet jo në të gjitha komunat ku aktiviteti ndikon.

Gjatë trajnimit pati shumë diskutime jo vetëm mbi procesin e tërheqjes së publikut në vendimmarrje, por edhe mbi saktësimin e kompetencave dhe roleve të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit, në procesin e vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis apo saktësimin e kompetencave mes tyre dhe pushtetit vendor.

VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS JANAR 2017

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi	Hartoi Dosjen
1	Mati Hydropower 5750	VTH HEC Mat 1	Mat, Dibër	Deklaratë Mjedisore	Sulejman Sulçe
2	Mati Hydropower 5751	VTH HEC Mat 2	Mat, Dibër	Deklaratë Mjedisore	Sulejman Sulçe
3	Mati Hydropower 5752	VTH HEC Mat 3	Mat, Dibër	Deklaratë Mjedisore	Sulejman Sulçe
4	Blaed Trade	VP Magazinë 1 kat, prodhimesh bujqësore dhe ushqimore	Shënkoll, Lezhë	Vendim për VNM Paraprake	EMC
5	Aquila Group	VP Magazinë industriale 1 kat,	Rruga dytësore Tiranë-Qafa e Kasharit, Mëzes, Tiranë	Vendim për VNM Paraprake	Laert Shehu
6	Pitagora Konstruksion	VP Godinë banimi e shërbimesh 1, 7 kt, 2 kt nëntokë	Tiranë	Vendim për VNM Paraprake	Laert Shehu
7	Ibrahim Haxhi Zeneli	VP objekt banimi 3 kat , me 1 kat nëntokë	Mullet, Tiranë	Vendim për VNM Paraprake	EMC
8	Elba gas	VP Prodhim SO2 (Ndryshim të kapacitetit prodhues nga 16 kg/orë në 500 kg/orë)	Elbasan	Vendim për VNM Të Thelluar	Lila Karaj
9	S.M.D Saranda Nr.196	VP Hotel 3, 4 kt, 1 kt parkimi nëntokë	Sarandë	Vendim për VNM Paraprake	Laert Shehu
10	Kazazi Farm	VP Rritje intesive e kafshëve	Dushk, Lushnje	Vendim për VNM Paraprake	Laert Shehu
11	Projekti i Ujit të Pijshëm	Projektim dhe mbikqyrje e ndërhyrjes në sistemin e kanalizimeve të ujërave të ndotur të Durrësit	Bashkia Durrës	Vendim për VNM Paraprake	Manushaqe Jace
12	Alfa Industries	VP Riciklim të anijeve në përfundim të jetës së tyre- kantier anijesh	Durrës	Vendim për VNM Paraprake	Denisa Kola
13	D-AMA	VP projektin “Pasurim minerali kromi e depozitim të masës sterile”	Maja e Kurorës, Cerrunje, Klos, Dibër	Vendim për VNM Paraprake	Remzi Pupli



2 SHKURT
ZONAT RAMSAR NË SHQIPËRI

SEKTORI I TRANSPARENÇES DHE KOMUNIKIMIT
Email: info@moe.gov.al

DËGJESAT E PUBLIKUT NË MUAJIN JANAR



Ministria e Mjedisit dhe projekti IBECA, projekti i Bashkimit Evropian në Tiranë organizoi dëgjueshën me publikun, por dhe me grupet e interesit për aktet ligjore në fushën e ndryshimeve klimatike.

Kështu në ambientet e Hotel Tiranës më 28 Shkurt 2017 u prezantua drafti i rishikuar për herë të tretë i Ligjit për "Ndryshimet Klimatike" si dhe drafti i rishikuar i Vendimit të Këshillit të Ministrave për "Monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve serrë si dhe informacione të tjera që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar".

Takimin e hapi znj. Laureta Dibra, përgjegjëse e Sektorit të Ajrit dhe Ndryshimeve Klimatike, në Ministrinë e Mjedisit. Ajo falenderoi ekspertët e projektit IBECA, që kanë punuar me aktet ligjore, akte të cilat janë domosdoshmëri për Shqipërinë, pasi pas vitit 2020 kur hyn në fuqi Marrëveshja e Parisit, ku vendit tonë do i duhet të ndërmarri hapa konkretë për reduktimin e shkarkimeve në ajër.

Më pas takimin e përshëndeti dhe z. Antoine Avignon, përfaqësues i Bashkimit Evropian, i cili shprehu kënaqësinë që Shqipëria është përfshirë në këtë angazhim mbarë Evropian në procesin e masave për t'iu përgjigjur ndryshimeve klimatike. Ai theksoi se ndërmarra e këtyre masave ligjore mundëson që Shqipëria të përbushë detyrimet e saj kundrejt marrveshjeve ndërkombëtare ku është palë. Ai gjithashtu i ftoi të pranishmit të ishin aktivë gjatë këtij takimi, pasi ata mund të ndihmonin me komentet dhe sygjerimet e tyre për mirësimin e drafteve që po diskutoheshin.

Më pas një prezantim i përgjithshëm i masave ligjore të hartuara u mbajt nga znj. Narin Panariti, zëvendës drejtuese e projektit IBECA, në fjalën e saj ajo theksoi rëndësinë e kësaj baze ligjore të draftuar nga grupi teknik i projektit në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit, por dhe në proces konsultimi me të gjitha ministrinë e linjës apo aktorë që do të ndikohen nga kjo bazë ligjore e hartuar tashmë. Ajo prezantoi kryesisht draft Ligjin për "Ndryshimet Klimatike".

"Qëllimi i këtij ligji, - nënvizoi znj. Panariti, - është të krijojë bazën ligjore për integrimin e politikave dhe për masa efektive që mundësojnë: plotësimin e detyrimeve të RSH ndaj Konventës për arritjen e objektivit final të saj, përmes nxitjes së reduktimit të shkarkimeve të GES dhe ruajtjes dhe rritjes së përhithësve dhe rezervuarëve të vendit; gjithashtu ka si qëllim dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në nivel kombëtar dhe/ose lokal; si dhe evidentimin e arritjeve të vendit në këto drejtime duke përdorur metodologji sipas modeleve të Konventës dhe të BE-së.

Së fundmi znj. Elena Stefanoni pjesë e grupit teknikë që ka punar për hartimin e akteve ligjore, mundësoi për të pranishmit një prezantim të formës por dhe të përmbajtjes të draft Vendimit të Këshillit të Ministrave për "Monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve serrë si dhe informacione të tjera që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar". Qëllimi i këtij projekt vendimi është të krijohet një mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e GES dhe të informacioneve të tjera që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar.

Më pas nga të pranishmit pati diskutime si nga përfaqësues të sektorit të energjitikës si dhe nga shoqata mjedisore EDEN.



AKTIVITETET BIOBLIZ GJATË MUAJIT JANAR

Në vijim të aktiviteteve të këtij projekti janë dhe orët e hapura mjedisore, që zhvillohen në një shkollë nëntëvjeçare të çdo rrethi. Kështu, gjatë muajit shkurt, vijuan aktivitetet e BioBlitz, në qytetet e Lushnjës, Vlorës, Shkodrës dhe Beratit .

LUSHNJE



Në qytetin e Lushnjës, aktiviteti u zhvillua me klasat e 9-ta të shkollës "Kongresi i Lushnjës". Duke qenë që ky qytet ka pranë dhe ligatinën e Karavastasë, dita kur u zhvillua ora e hapur ishte në Ditën Botërore të Ligatinave dhe nxënësit ishin mjaft aktivë për të treguar pasuritë natyrore të zonës së tyre.

VLORË



Një ndjeshmëri të lartë për çështjet e mjedisit kishin dhe fëmijët e shkollës "Jani Minga", në qytetin e Vlorës, të cilët kishin njohuri mbi problematikat kryesore mjedisore të qytetit të tyre, gjithashtu njihnin dhe aktivitetet njerëzore që i shkaktonin këto problematika. Ata u treguan mjaft të interesuar për të ditur të drejtat e tyre për informimin mbi çështjet mjedisore dhe në veçanti për aktivitetet mjedisore që kërkonin tërheqjen e mendimit të publikut në vendimarrje.

SHKODËR

E zhurmshme, por me fëmijë që artikulojnë plot pyetje mbi mjedisin, ishte dhe aktiviteti i zhvilluar në kuadër të BioBlitz Albania dhe në qytetin e Shkodrës. Mësuesit e lëndës së biologjisë së shkollës "Ismail Qemali" vlerësuan shumë dhurimin e mjeteve nga ana e Projektit për laboratorin e kësaj shkolle.



BERAT



BioBlitz zbriti dhe në qytetin e bukur të Beratit. Edhe këtu si në të gjitha shkollat e tjera të përfshira në këtë aktivitet të edukimit mjedisor, ju bë një prezantim për mjedisin në tërësi dhe në veçanti për të dhënat mjedisore që ka qarku ku shtrihet Berati.

BURRELI

Ekipi i Ministrisë së Mjedisit dhe Projektit BioBlitz Albania ishin po në muajin shkurt, për të zhvilluar orën e hapur dhe në shkollën 9-vjeçare "Mustafa Gjestila", në qytetin e Burrelit. Përfaqësuesit nga Ministria e Mjedisit, por dhe nga Projekti iu dhanë njohuri fëmijëve të klasave të nënta të kësaj shkolle, mbi problematikën mjedisore të rrethit të tyre. Gjithashtu, ata diskutuan me fëmijët dhe larminë biologjike të rrethit të Matit, si dhe detyrimet dhe të drejtat

